



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 46
Prishtinë, më 26 janar 2012

PROCESVERBAL

**IMBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 26 JANAR 2012**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 68 deputetë.

Kryetari procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën: në emër të GP të PDK-së - Bekim Haxhiu, në emër të GP të AAK-së - Burim Ramadani, në emër të GP të lëvizjes “Vetëvendosje” , Rexhep Selimi, në emër të GP të Koalicionit Kosova e Re, Muhamet Mustafa, si dhe deputetët: Hashim Deshishku, Alma Lama, Ganimete Musliu, Nijazi Idrizi, Albulena Haxhiu dhe Rita Hajzeraj - Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Ismet Beqiri, emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozoi që pika e 12 e rendit të ditës- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti**, të mos shqyrtohet në Kuvend dhe t'i kthehet Qeverisë së Kosovës, në ripunim, me arsyetimin se nuk e rregullon në mënyrën e duhur çështjen e skemave pensionale.

Ministri **Nenad Rashiq**, në emër të Qeverisë së Kosovës, shpjegoi materien që rregullon Projektligji për skemat pensionale të financuara nga shteti. Ai kërkoi që Kuvendi ta miratojë, në parim, Projektligjin.

Kryetari kërkoi deklarinimin e grupeve parlamentare lidhur me propozimin e kryetarit të GP të LDK-së.

Suzan Novoberdaliu, në emër të Komisionit funksional, tha se komisioni më. 25 janar 2012 ka pranuar peticionin e Koalicionit të Pensionistëve të Kosovës, mirëpo të njëjtin deri më tash nuk kemi mundur ta shqyrtojmë.

Kurtan Kajtazi, në emër të GP të PDK-së, tha se Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti, nuk duhet të shqyrtohet në mbledhjen e sotme, por të shtyhet në njërën nga mbledhjet e radhës.

Visar Ymeri, në emër të GP të lëvizjes “Vetëvendosje” tha se e përkrah propozimin e GP të LDK-së që Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti t'i kthehet Qeverisë, për ripunim.

Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së tha se mbështet propozimin që ky projektligj të shtyhet.

Pas këtyre deklarimeve, kryetari hodhi në votim propozimin e GP të LDK-së. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 41,
Kundër----- 28,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Projektligji për skemat pensionale të financuara nga shteti, i kthehet Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ripunim.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit doganor dhe akcizave,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për fondet pensionale të Kosovës,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për diasporën e Kosovës,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bibliotekat në Republikën e Kosovës,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për teatrot.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për ministrin, Ramë Buja, në lidhje me përgatitjet e Ministrisë që ai drejton për realizimin e projektit të ashtuquajtur të teksteve të integruara për arsimin fillor në Kosovë.

Ministri Ramë Buja nuk ishte prezent në sallë.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 20 e 23 janar 2012

Deputeti **Arsim Bajrami** tha se Procesverbali, në faqen 5, nuk shpreh atë se çfarë deputetët kanë vendosur, nëse krahasohet me transkriptin, në faqe 39 dhe 40. Ai kërkoi që procesverbali të korrigjohet.

Kryetari sqaroi mënyrën e funksionimit të komisioneve. Komisionet, sipas Rregullores së Kuvendit, kur kalon një ligj, kanë afat brenda dy muaj t'i dorëzojnë raportet me rekomandime.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 20 dhe 23 janar 2012.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër.

Zëvendëskryeministri **Bujar Bukoshi** tha se arsyeja për hartimin e këtij projektligji është përcaktimi i rregullave për sigurimin e bazës ligjore për mbrojtjen e të drejtave elementare të një kategorie të personave me aftësi të kufizuara, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Më tej ai tha se projektligji u adresohet të gjithë personave të verbër dhe personave pjesërisht të verbër në Republikën e Kosovës.

Më pas ai u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji si dhe në strukturën e tij.

Në fund, zëvendëskryeministri i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, dhe në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Suzan Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Kurtan Kajtazi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Rita Hajzeraj-Beqaj, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Albana Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Kimete Bajraktari, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostiq dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, si dhe deputetët, Donika Kadaj-Bujupi, Aurora Bakalli, Ganimete Musliu, Vjollca Krasniqi, Salihe Mustafa dhe Teuta Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim Projektligjin për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	64,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme.

Ministri **Bedri Hamza** tha se qëllimi i këtij projektligji është ndryshimi i normës për pagesën e tatimit në pronën e paluajtshme dhe procedurës së ankimit.

Më tej ai tha se projektligji rregullon çështjet që kanë të bëjnë me rritjen e normës së tatimit në pronën e paluajtshme, nga 0.05% në 0.15%.

Më pas ai u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji si dhe në strukturën e tij.

Në fund, ministri Bedri Hamza i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetët, Ali Sadriu, Gëzim Kelmendi, Haki Demolli, Imri Ahmeti, Naser Osmani dhe ministri Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 51,
Kundër----- 21,
Abstenime----- 5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

Ministri **Bedri Hamza** tha se arsyeja e nxjerrjes së këtij projektligji është avancimi dhe konsolidimi i bazës ligjore që ka të bëjë me veprimtarinë bankare dhe jobankare të institucioneve që angazhohen në këtë veprimtari.

Më tej ai tha se projektligji rregullon veprimtarinë dhe aktivitetet financiare të bankave, institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare, aksionarëve të tyre administratorëve, punonjësve dhe filialeve të tyre.

Më pas ai u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji si dhe në strukturën e tij.

Në fund, ministri Bedri Hamza i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Latif Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar

të Lëvizjes Vetëvendosje, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Muhamet Mustafa, dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Fikrim Damka, si dhe deputeti, Arben Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 63,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit doganor dhe akcizave

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit doganor dhe akcizave.

Ministri **Bedri Hamza** tha se gjatë hartimit të këtij projektligji kemi bashkëpunuar me përfaqësues të Komisionit Evropian dhe se është bërë harmonizimi më i mirë i Projektligjit me rregulloret e BE-së, siç është Rregullorja ECC nr. 2913/92.

Më tej ai tha se projektligji rregullon çështjet që kanë të bëjnë me kushtet dhe procedurat për përfitimin e statusit të operatorit të autorizuar ekonomik dhe lehtësirat që përfitojnë, plotësimin e dispozitave për mënyrën, kohën, afatet, vendin e parashtrimit dhe tërheqjes së deklaratës përmbledhëse me rastin e importit dhe eksportit të mallrave.

Më pas ai u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji si dhe në strukturën e tij.

Në fund, ministri Bedri Hamza i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit doganor dhe akcizave.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit doganor dhe akcizave.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sali Asllanaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Goran Marinković dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Myfera Shinik, si dhe deputeti, Lutfi Zharku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit doganor dhe akcizave. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit doganor dhe akcizave.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqes dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Ministri **Bedri Hamza** tha se qëllimi i këtij projektligji është ndryshimi i normës për pagesën e tatimit për veprimtaritë afariste me të ardhura bruto vjetore deri në 50 mijë €, të cilat taten për të ardhurat bruto të realizuara nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit, në çdo tremujor, si dhe ndryshimi i procedurës së ankesës.

Më pas ai u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji, si dhe në strukturën e tij.

Në fund, ministri Bedri Hamza i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostiq, dhe në emër të Grupit Parlamentar "6+", Myfera Shinik, si dhe deputetët, Hykmete Bajrami, Agim Kuleta dhe ministri Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 50,
Kundër----- 16,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale.

Ministri **Bedri Hamza** tha se qëllimi i këtij projektligji është ndryshimi i normës për pagesën e tatimit për veprimtaritë afariste me të ardhura bruto vjetore deri në 50 mijë €, të cilat taten për të ardhurat bruto të realizuara nga shërbimet, veprimtaritë profesionale, të zanatit, të argëtimit, në çdo tremujor, si dhe ndryshimi i procedurës së ankesës.

Më tej ai tha se procedurat e ankimit duhet të zhvillohen në pajtim me dispozitat e përcaktuara në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat, të cilin do ta shqyrtojmë gjithashtu në mbledhjen e sotme.

Në fund, ministri Bedri Hamza i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Latif Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Milivoje Stojanoviq, dhe në emër të Grupit Parlamentar "6+", Myfera Shinik, si dhe ministri Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 47,
Kundër----- 5,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në të ardhurat personale.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat.

Ministri **Bedri Hamza** tha se qëllimi i këtij projektligji është themelimi i Divizionit Fiskal dhe ndryshimi i procedurës së ankesës.

Më tej ai theksoi se me këtë projektligj parashihet që nga 1 janari 2013, kompetencat e Bordit të Pavarur për Rishqyrtime transferohen në kuadër të kompetencave të Divizionit Fiskal, i cili do të veprojë në kuadër të Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Më pas ai u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji si dhe në strukturën e tij.

Në fund, ministri Bedri Hamza i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Goran Marinković, dhe në emër të Grupit Parlamentar "6+", Duda Balje, si dhe deputetët: Lutfi Zharku, Sadri Ferati, Imri Ahmeti ministri Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 75,

Kundër----- 0,

Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për fondet pensionale të Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për fondet pensionale të Kosovës.

Ministri **Bedri Hamza** tha se qëllimi i këtij projektligji është të përcaktojë format e ndryshme të sigurimit pensional qeveritar dhe privat në Republikën e Kosovës.

Më tej ai theksoi se me këtë projektligj parashihet përcaktimi i bazës së sistemit pensional që përfshin pensionet bazë dhe pensionet e kursimeve individuale, që sipas këtij projektligji janë të detyrueshme, fondet plotësuese pensionale të punëdhënësit dhe pensionet plotësuese individuale.

Më pas ai u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji si dhe në strukturën e tij.

Në fund, ministri Bedri Hamza i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për fondet pensionale të Kosovës.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për fondet pensionale të Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur në këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjona, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Latif Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Goran Marinković dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetët, Naser Osmani, kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, si dhe ministri Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim Projektligjin për fondet pensionale të Kosovës. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 64,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 10.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për fondet pensionale të Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë.

Ministri **Nenad Rashiq** tha se në dispozitat e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, është hasur në paqartësi, konfuzion dhe në dispozita kontradiktore. Në praktikë ka ndodhur që disa familje edhe pse kanë qenë të varfëra nuk kanë mundur të kualifikohen si të tilla, nga se ligji ka pasur zbrastësira.

Në vazhdim, ministri Rashiq tha se me këtë projektligj adresohen çështjet që kanë të bëjnë me përcaktimin e kriterëve të reja për përfituesit e ndihmave sociale, eliminimin e disa kriterëve financiarë për ndihma sociale të cilat nuk kanë qenë në përputhshmëri me gjendjen reale materiale të familjes, si dhe përfshirjen e pensioneve bazë, pensioneve me aftësi të kufizuara si të hyra materiale të llogaritshme, me rastin e përzgjedhjes së familjes si përfitues i ndihmave sociale.

Më pas ai u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji si dhe në strukturën e tij.

Në fund, ministri Nenad Rashiq i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Flora Brovina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Bahri Thaçi, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes” Vetëvendosje”, Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Boban Todoroviq, dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetja, Salihe Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	62,
Kundër-----	2,
Abstenime-----	2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për diasporën e Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për diasporën e Kosovës.

Zëvendëskryeministri **Bujar Bukoshi** tha se Projektligji për diasporën e Kosovës ka për qëllim ruajtjen e identitetit dhe zhvillimin e kulturës së diasporës dhe lidhshmërinë e tyre me Ministrinë e Diasporës të Republikës së Kosovës.

Më tej ai theksoi se me këtë projektligj synohet plotësimi i zbrastësirave ligjore dhe shfuqizimi i ligjit nr. 03/L-171 për Mërgatën e Kosovës.

Më pas ai u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji si dhe në strukturën e tij.

Në fund, zëvendëskryeministri Bujar Bukoshi i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për diasporën e Kosovës.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për diasporën e Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Idriz Vehapi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Vataj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes” Vetëvendosje”, Florin Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Jeton Svirca, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Milivoje Stojanoviq, dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Enis Kervan, si dhe deputetët: Sabri Hamiti, Hydajet Hyseni, Haki Demolli, Sala Berisha –Shala, Flora Brovina, Lutfi Haziri, Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit dhe Albin Kurti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim Projektligjin për diasporën e Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	49,
Kundër-----	17,
Abstenime-----	7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për diasporën e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bibliotekat në Republikën e Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për bibliotekat në Republikën e Kosovës.

Ministri **Memli Krasniqi** tha se Projektligji për bibliotekat në Republikën e Kosovës ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë së bibliotekave, kushteve dhe mënyrën e kryerjes së punëve, strukturën, financimin, menaxhimin dhe kontrollimin e bibliotekave, zhvillimin e koleksioneve të bibliotekave dhe kualifikimet e stafit të bibliotekave.

Më tej ai theksoi se ky projektligj është i një rëndësie të veçantë, ngase mungon legjislacioni gjithëpërfshirës në këtë fushë.

Më pas ai u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji si dhe në strukturën e tij.

Në fund, ministri **Krasniqi** i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për bibliotekat në Republikën e Kosovës.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për bibliotekat në Republikën e Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Idriz Vehapi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Xhevahire Izmaku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Jeton Svirca, dhe në emër të Grupit Parlamentar SLS, Milivoje Stojanoviq, si dhe deputetët: Lirije Kajtazi, Sali Morina dhe Muhamet Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim Projektligjin për bibliotekat në Republikën e Kosovës. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	64,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për bibliotekat në Republikën e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për teatrot

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për teatrot.

Ministri **Memli Krasniqi** tha se Projektligji për teatrot është i një rëndësie të veçantë, sepse deri më tani vendit tonë i mungon legjislacioni nga kjo fushë.

Më tej ai theksoi se me këtë projektligj përcaktohet në mënyrë më të qartë: fushëveprimi i ligjit, qëllimi, themelimi dhe organizimi i teatrove publike, këshilli drejtues i teatrove, teatrot e pavarura, lënda arkivore, etj.

Më pas ai u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji si dhe në strukturën e tij.

Në fund, ministri **Krasniqi** i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për teatrot.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për teatrot.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Idriz Vehapi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Xhevahire Izmaku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lirije Kajtazi, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të Grupit

Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Jeton Svirca, dhe në emër të Grupit Parlamentar SLS, Milivoje Stojanoviq, si dhe deputetët, Blerta Deliu-Kodra, Sadri Ferati, kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi dhe ministri Memli Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim Projektligjin për teatrot. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	52,
Kundër-----	10,
Abstenime-----	2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për teatrot.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare në orën 19:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale